

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurit D H ., nga Prizreni, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH ne Prizren PP/II.nr.3130/15 e dt.29.02.2016 për shkak të veprës penale të lëndimit te lehte trupor nga neni 188/1-4 të KP-së , në prezencën e të akuzuarit , prokurorit te shtetit Elfete Purova, më dt.03.07.2017, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

D . H ., 1 .. ne Prizren me banim ne lagjen O .. rr. .. pn nga i ati H ., dhe e ema F .., ka te keryer shkollën fillore i pa martuar , punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptare - shtetas i R te Kosovës

E S H T E F A J T O R

Se me dt. 19.03.2015 rreth orës 22,30 min ne Prizren, ne rr. i shkakton lëndime te lehta trupore te miturit – te dmetuarit A .. Sh .. qe rezulton me pasoja te përkohshme ne shëndet ne ate meynre qe pa asnjë arsy e sulmon me grushta ne fytyre me qrast i shkakton lëndime te lehta trupore dhe ate ndrydhje te kokërdhokut te syrit te majte dhe skuqje te konjunktivës.

Këso dore ka kryer veprën peanle lëndim i lehta trupor nga neni 188 /1-4 të KP.


Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3,4.41.43./46, të KP-se, , te pandehurit i shqipton :

D E N I M M E G J O B Ë

Duke i shqiptuar dënimin me të holla ne shume prej 240 (dyqindekaterdhjete) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhirollagarinë e kesaj gjykate, nga dita e plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi , e po qese dënnimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendor, i njëjtë do te zëvendësohet me denim burgu duke llogarite 20 euro , nje dite burg (12 dite burg) .

I demtuari A .. Sh .. nga Prizreni rr. nr. perf. Ligjore Xh .. Sh .. , per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest juridiko civil.

Obligohen I pandehuri qe ti paguajne te gjitha shpenzimet e procedures penale sa ato behen ne baze te llogarise se gjykates,ne emer te ekspertizes mjekoligjore Shumen prej 20,44 euro, kurse ne emer te te paushallit gjyqesor te paguajn shumen prej 20 euro, e te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi nen kerçnim te ekzekutimit te dhunshem.



Arsy etim

Prokuroria Themelore në Prizren , i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.3130/15 e dt.29.02.2016 kundër te pandehurit D . H nga Prizreni, për shkak të veprës penale të lëndimit te lehte trupor nga neni 188/1/4 të KP-së

I pandehuri D . H ., në shqyrtim fillestar në tërsi kanë pranuar veprën penale e cila iu vehet në barrë sipas aktakuzës.

Gjyqtari gjykues përcakttoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajit, pranimi është bere vullnetarisht, dhe mbështetet ne faktet e qeshtjes qe përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike dhe pas marrjes se mendimit nga ana e prokurorit te shtetit ka pranuar pranimin e fajsisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale lëndimit te lehte trupor nga neni 188/1-4 te KP-së prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me gjobë duke qenë i bindur se me këtë lloj dënim i do te arrihet qëllimi i të njëjtit.

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe renduese, secilën ne veçanti dhe lidhshmérinë ne mes te tyre ne te gjitha rrethanat tjera te cilat ishin me ndikim ne përcaktimin dhe qëllimin e dënitit.

Si rrethana renduese gjykata kishte parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit te vlerës se mbrojtur, kurse ne rrethana lehtësuese pranimin e fajit, pendimin per veprën dhe rrethanat familjare.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest te rregullt civil u mbështet ne neni 463/2 te KPP-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.459/16 të dt.03.07.2017

Procesmbajtësja:

Halime Nixha

Gjyqtari:

Refki Piraj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit ne Prishtine , e nëpërmjet të kësaj gjykate.